



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 3431 prot.

Elbasan, më 03.2024

Lënda: Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD**

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.24 datë 28.02.2024 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Majlinda PERRIU**



343

05.3



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
BASHKIA LIBRAZHID  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.04.03.2024

Nr. 188/ prot

Nr.24 dt.28.02.2024

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”. VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008,të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen.shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullor publik”. pasi dëgjoji relacionin e Drejtorisë së Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 28.02.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

**VENDOSI:**

- 1.Të miratojë me shkrim vazhdimin e procedurave të mëtejshme të dhënies në përdorim të fondit pyjor e kullor publik për ushtrimin e veprimtarive për parqe fotovoltaike për pjesë të ngastrës nr. 125a te Ekonomisë pyjore Librazhd me sipërfaqe 0.95 ha.
2. Procedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Sekretari i Përgjithshëm, Sektori Juridik, Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave Bashkisë Librazhd, Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tijë.

SEKRETAR I KËSHILLIT  
Elson MALLUFA

KRYETARI I KËSHILLIT  
Mitat BICAKU



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA LIBRAZHË**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE**

**RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN**

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”**

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”.

VKM Nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”.

VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.01 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar,

Drejtorja e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pasi kreu studimin e të gjitha ngastrave të fondit pyjor që do jepen në përdorim, për qëllime parqe fotovoltaike për pjesë të ngastrës nr. 125a të Ekonomisë pyjore Librazhd me sipërfaqe 0.95 ha i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e kësaj pjesë të ngastrës pyjore.

Ky qëllim është i orientuar në politikat e qeverisë Shqiptare për rritjen e kapacitetit të fuqisë prodhuese të energjisë elektrike nga energjia e rinovueshme e cila do ndikojë në rritjen e të ardhurave për bashkinë Librazhd dhe investime në fondin pyjor e kullor.

Veprimtaria e parashikuar në këto sipërfaqe nuk e dëmtojnë ekosistemin e zonës ku do të instalohen këto parqe fotovoltaike. Nisur nga arsyet e mësipërme ne propozojmë për dhënie në përdorim të sipërfaqeve që bëjnë pjesë në fondin pyjor/kullor të bashkisë Librazhd për parqe fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë ku veprimtaria e mësipërme do të ketë një ndikim pozitiv në të ardhmen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetin rrethues, rritjen e vlerave ekonomike në zone dhe krijimin e vendeve të reja pune.



Theksojmë që këto sipërfaqe janë të formës së përdorimit shkurre, kullotë dhe shkëmbore. Në këto sipërfaqe nuk ka studime dhe plane zhvillimi për këto territore si dhe investime të tjera afatgjatë.

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të këtyre sipërfaqeve të fondit pyjor të Bashkisë Librazhd në mënyrë që Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të vazhdojë procedurat e mëtejshme.

Jemi në pritje të miratimit nga ana J' uaj.

**Përgjegjësi i Menaxhimit**

**Ing. Bledar ÇOTA**





**DREJTORI**

**Aleksandër BRAZHDA**





# FRAGMENT HARTE ORTOFOTO EKONOMIA PYJORE LIBRAZHID



1:10,000

Sipërfaqja qe jepet ne perdorim 0.95 ha  
Zona Kadastrale 1527 Numri i pasurise 600  
Numri kadastral pyjore ngastral 125

## Legjenda:



Ngastra 125 Ekonomia Pyjore Librazhd